

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët Nesrin Lushta, kryetare e kolegjit, Agim Maliqi dhe Rasim Rasimi, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të dënuarit J.G., për shkak të veprës penale lëndimi i rëndë trupor nga neni 189 par.5 lidhur me par.1 nënpar.1.1 të KPRK-së dhe veprës penale asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 333 par.1 i KPRK-së, duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur nga mbrojtësi i të dënuarit, av. T.B., kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë - Departamenti për Krime të Rënda PKR.nr.111/2017 të datës 15.01.2018 dhe aktgjyqimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.65/2018 të datës 20.03.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur më 5 qershor 2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit J.G., e paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë - Departamenti për Krime të Rënda PKR.nr.111/2017 të datës 15.01.2018 dhe aktgjyqimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.65/2018 të datës 20.03.2018.

A r s y e t i m

Vendimi i Gjykatës Themelore

Gjykata Themelore në Gjakovë - Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin PKR.nr.111/2017 e datës 15.01.2018, të dënuarin J.G. e ka shpallur fajtor për veprën penale lëndimi i rëndë trupor nga neni 189 par.5 lidhur me par.1 nënpar.1.1 të KPRK-së dhe e ka gjykuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 1 (një) viti e 10 (dhjetë) muaj, kurse për veprën

penale asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 333 par.1 i KPRK-së, e ka gjykuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 4 (katër) muaj, ashtu që i ka shqiptuar dënim unik burgimi në kohëzgjatje prej 2 (dy) vitesh. Është obliguar në pagesën e paushallit gjyqësor në shumë prej 50 (pesëdhjetë) € dhe shpenzimet e procedurës penale në shumë prej 50 (pesëdhjetë) €, kurse të dëmtuarit, për realizimin e kërkesës pasurore juridike janë udhëzuar në kontest civil.

Vendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës

Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin PAKR.nr.65/2018 e datës 20.03.2018, ka aprovuar si të bazuar ankesën e mbrojtësit të të dënuarit dhe e ka ndryshuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, vetëm përkitazi me dënimin e shqiptuar, ashtu që për veprën penale lëndimi i rëndë trupor nga neni 189 par.5 lidhur me par.1 nënpar.1.1 të KPRK-së e ka gjykuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 1 (një) viti e 6 (gjashtë) muaj, kurse për veprën penale asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 333 par.1 i KPRK-së, e ka gjykuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 3 (tre) muaj, ashtu që i ka shqiptuar dënim unik burgimi në kohëzgjatje prej 1 (një) viti e 6 (gjashtë) muaj në të cilin dënim i është llogaritur koha e kaluar në paraburgim prej datës 16.10.2017 deri më datën 15.01.2018. Pjesa tjetër e aktgjykimit ka mbetur e paprekur.

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë

Kundër këtyre aktgjykimëve kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit, av. T.B. nga Gj., për shkak të shkeljes së ligjit penal, shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale e të cilat shkelje kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës ta aprovojë si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, të ndryshojë aktgjykimet e kundërshtuara dhe të dënuarit ti shqiptoj dënim më të ulët, përkatësisht dënim të kushtëzuar.

Mendimi i Prokurorit të Shtetit

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit e Kosovës, me shkresën KMLP.nr.93/2018 e datës 07.05.2018, ka propozuar që kërkesa të refuzohet si e pabazuar.

Pretendimet e paraqitura në kërkesë

Në kërkesë mbrojtësi i të dënuarit thekson se dënimet e shqiptuara me aktgjykimet e gjykatës së shkallës së parë dhe gjykatës së shkallës së dytë janë shumë të larta dhe në disproporcion me veprën penale të kryer nga i dënuari dhe po ashtu edhe me kushtet dhe rrethanat e rastit. Me rastin e shqiptimit të dënimit nuk janë marrë parasysh si rrethana lehtësuese se i dënuari është mbajtës i familjes, se nuk ka punësim të përhershëm dhe se është baba i dhjetë fëmijëve, po ashtu edhe faktet se të dëmtuarit nuk i janë bashkangjitur ndjekjes penale dhe nuk kanë paraqitur kërkesë pasurore juridike.

Po ashtu pretendohet se nuk është çmuar mjaftueshëm pranimi i fajësisë dhe favoret që rrjedhin nga një pranim i tillë, meqë po të çmoheshin këto rrethana nga gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e shkallës së dytë, me rastin e shqiptimit të dënimit do të shqiptohej dënim më i butë.

Më tutje pretendohet se edhe me anë të një dënimi më të butë, por edhe me dënim me kusht do të arrihej qëllimi i dënimit. Kurse shkeljet e ligjit penal lidhur me matjen e dënimit në dëm të të dënuarit janë bërë edhe nga gjykata e shkallës së dytë pasi që gabimisht janë aplikuar dispozitat e KPRK-së.

Gjetjet e Gjykatës Supreme të Kosovës

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të KPPK-së dhe pas vlerësimit të pretendimeve në kërkesë, gjeti se:

kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë nuk është e bazuar.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimi i mbrojtësit të të dënuarit, është i pabazuar, ngase aktgjykimet e kundërshtuara, nuk përmbajnë shkelje të pretenduara të ligjit penal dhe shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale.

Në rastin konkret është e rëndësishme të theksohet i dënuari ka bërë pranimin e fajësisë në shqyrtimin fillestar dhe si rezultat i konstatimit të gjykatës se janë përmbushur kriteret e përcaktuara në nenin 248 të KPPK-së, pranimi i fajësisë është aprovuar dhe shqyrtimi fillestar ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Bazuar në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë rezulton se me rastin e shqiptimit të dënimit janë çmuar mjaftueshëm të gjitha rrethanat lehtësuese për të shqiptuar dënim adekuat përkatësisht për të individualizuar dënimin. Me këtë rast janë marrë si rrethana lehtësuese pranimi i fajësisë, sjellja korrekte gjatë shqyrtimit fillestar, kërkim falja të dëmtuarve si dhe fakti se i dënuari më parë ka qenë i padënuar për ndonjë vepër tjetër penale. Po ashtu janë vlerësuar edhe rrethanat familjare, se i dënuari jeton në gjendje të vështirë ekonomike dhe fakti se është mbajtës i familjes së tij me shumë anëtar.

Andaj, në rastin konkret në mënyrë të drejtë dhe të plotë, janë vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe me këtë drejtë është aplikuar ligji penal dhe pretendimi në fjalë nuk ishte i bazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, konstatojë se konform dispozitës se nenit 385 par.5 të KPPK, kur është fjala për vendimin për dënim, shkelje e ligjit penal bëhet kur në marrjen e vendimit për dënim, dënimi alternativ, vërejtja gjyqësore ose në marrjen e vendimit për masën e trajtimit të detyrueshëm për rehabilitim apo për konfiskim të dobisë pasurore të fituar me veprën penale, gjykata ka tejkalluar kompetencat ligjore.

Në rastin konkret gjykata e shkallës së parë ka shqiptuar llojin e dënimit të paraparë për këtë vepër penale gjegjësisht dënimin me burgim brenda minimumit dhe maksimumit të paraparë me ligj, kështu që pretendimi i të dënuarit i paraqitur në kërkesë se aktgjykimi është përfshirë në shkelje të ligjit penal nuk është i bazuar.

Kurse përkitazi me pretendimet e tjera të theksuara për shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkelje tjera që kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor edhe pse janë cekur si shkelje, megjithatë në kërkesë nuk është paraqitur asnjë pretendim konkret, andaj, këto pika të kërkesës nuk u trajtuan bazuar në nenin 436 par.1 të KPPK-së, se me rastin e

vendosjes së kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë, Gjykata Supreme e Kosovës kufizohet vetëm në verifikimin e shkeljeve në të cilat pretendon paraqitësi i kërkesës.

Nga sa u parashtrua më lartë e në kuptim të nenit 437 par.1 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.125/2018, më 5 qershor 2018

Procesmbajtësi,
Bujar Balaj

Kryetarja e kolegjit,
Nesrin Lushta